



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Zyra e Kryetarit të Komunës së Klinës

01 Nr. 06- 29629
Klinë, datë: 10.09/2026

PROCESVERBAL

Nga dëgjim i gjashtë publik për kornizen afatmesme buxhetore te vitev 2027-2029 të Komunës së Klinës, me banoret e fshatrave Ujmirë, Jashanicë, Pogragjë, Dush i Vogël, Shtaric, Dush, Resnik, Siqevë, Jelloc, Gjurgjevik i Madh, Qabiq, Doberdol te komunës së Klinës, me, datë 01.09.2026, ora 17:00, shkolla fillore "Ali Krasniqi" Ujemirë.

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutin e komunës së Klinës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e këtij procesverbali mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri me datë 07/09/2026 në emalin egzon.sejdiu@rks-gov.net ose fizikisht në zyrën e pranimi në Komunën e Klinës.

Ky procesverbal është një dokument publik i cili hartohet sipas standardeve të Ligjit për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjit për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Ky dokument është publik në faqen e komunës në dy versione në PDF dhe Word dhe në arkivin e komunës i protokolluar sipas protokollit zyrtarë.

Hartuesi i këtij procesverbali ka redaktuar të dhënat personale të palëve të cilat janë mbledhur gjatë procesit. Vetëm palët e autorizuar mund të kenë qasje në të dhënat personale të mbledhura gjatë këtij procesi të cilat janë të arkivuara në komunë.

Ky dokument përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit përmbledhjen nga takimi dhe në aneks materialet e bashkangjitura të cilat janë grumbulluar gjatë takimit.

Para nisjes së diskutimit të pranishmit i janë nënshtruar procesit të regjistrimit në listën e pjesëmarrësve.

Në listën e pjesëmarrësve ata kanë ofruar emrin mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë grumbulluar me qëllim të sigurimit të dëshmive për pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjimet buxhetore.

Të pranishmit janë pajisur me agjendën e takimit e cila u është dorëzuar në formë fizike dhe me materialet ku përfshihej prezantimi i Draft-Buxhetit i vitev 2027-2029 i cili është dorëzuar tek secili pjesëmarrës në formë fizike para të pranishmëve është prezantuar draft-buxheti edhe në formatin elektronik.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka nevojë për përkthyes apo interpretim për personat me aftësi të kufizuara.

Takimi ka nisur në ora 17:00 të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj, drejtor të drejtorive , anëtarë të grupit punues si dhe qytetar të ketyre fshatrave.

Nga qytetarët morën pjesë 9 persona, prej të cilëve, 9 burra,dhe 0 gra

Shtojca 6 – Fotografi nga dëgjim i gjashtë për kornizën afatmesme buxhetore e vitev 2027-2029 me banoret e Fshatrave: Ujemirë,Jashanicë,Pogragj,Dush i Vogel,Shtaric,Dush,Resnik,Siqevë,Jelloc,Gjurgjevik i Madhe,Qabiq,Doberdol e komunës së Klinës.



Takimi u hap nga Kryetari i Komunës së Klinës, Prof. Dr. Zenun Elezaj:

Të nderuar banorë të Ujmirit, Jashanicës, Pogragjës, Dushit, Dushit të Vogël, Shtaricës, Resnikut, Siqevës, Jellocit, Gjurgjevikut të Madh, Qabiqit dhe Dobërdolit, Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe për mundësinë që të diskutojmë së bashku për buxhetin e Komunës së Klinës për vitin 2027 buxheti i vitit 2027 do të fokusohet në nevojat kryesore të qytetarëve dhe në përfundimin e projekteve që kanë mbetur pa u realizuar prioritet do të kenë: Përfundimi dhe asfaltimi i rrugëve që kanë mbetur, mirëmbajtja dhe përmirësimi i rrugëve ekzistuese, ndërtimi dhe përmirësimi i kanalizimeve, zgjerimi i ndriçimit public, përmirësimi i furnizimit me ujë, mbështetja e bujqësisë dhe fermerëve, investimet në hapësirat dhe shërbimet publike ër rrugën prej rreth , do ta shqyrtojmë mundësinë më të afërt për ta përfshirë në planifikimet tona dhe për ta realizuar në përgjithësi, kemi punuar shumë që shumica e projekteve dhe rrugëve të përfundojnë rrugët që kanë mbetur janë të pakta dhe do të vazhdojmë të punojmë për përfundimin e tyre qëllimi ynë është që investimet të shpërndahen në mënyrë të drejtë dhe të orientohen aty ku nevoja është më e madhe ne duam që buxheti i vitit 2027 të sjellë punë konkrete dhe përmirësim të kushteve të jetesës për të gjithë banorët.

Faleminderit për bashkëpunimin dhe për besimin tuaj.

Diskutimet e pjesëmarrësve

Kadri Vishaj, Dobërdol

Kërkesa ime ka të bëjë me transportin e nxënësve ka filluar procesi mësimor, ndërsa këtë vit transporti për fëmijët ende mungon a do të ketë transport për nxënësit dhe kur pritet të fillojë?

Pergjigja e Kryetarit:

Transporti i nxënësve është në fazën përfundimtare dhe jemi pranë nënshkrimit të kontratës. E mira është se këtë vit pagesa e transportit do të mbulohet tërësisht nga Komuna ndryshe nga vitet e kaluara, kur 50% e pagesës e mbulonte Komuna dhe 50% prindërit, këtë vit Komuna do ta mbulojë 100% të kostos së transportit pritet që shumë shpejt, deri më 15 të këtij muaji, të sigurohet transporti për të gjithë nxënësit.

Tush Berisha,Doberdol

Kam disa kërkesa:

Vazhdimi i ndriçimit publik aty ku ka mbetur,kanalizimi është i bllokuar në tri pika dhe ka nevojë për intervenim,ndërtimi i trotuarit,ndërtimi i një parku te varrezat, në mënyrë që të krijohet një hapësirë e përshtatshme për banorët,vendosja e tabelave me emrat e fshatrave, pasi disa prej tyre ende nuk kanë tabela dhe emërtim të qartë.

Pergjigja e Kryetarit:

Sa i përket këtyre kërkesave, kemi kontratë të nënshkruar dhe pritet që së shpejti të fillojnë punimet për ndriçimin publik kemi planifikuar që të vendosim ndriçim me drita solare, të cilat nuk do të jenë të lidhura me rrjetin elektrik dhe nuk do të krijojnë shpenzime shtesë për Komunën dritat do të furnizohen përmes energjisë së diellit sa i përket trotuarit, pritet që punimet të fillojnë në pranverë dhe të vazhdojnë deri në përfundim të fshatit ndërsa, për tabelat me emrat e fshatrave, përfshirë Ujmirën dhe rrethinën, do ta planifikojmë që gjatë vitit të ardhshëm të vendosen tabela në të gjithë territorin e Komunës së Klinës.

Alfred Buzhala,Qabiq

Kërkesa ime për Komunën është ndërtimi i 175 metrave kanalizim, pasi kemi ndërtuar pesë shtëpi të reja dhe kemi nevojë për kyçje në rrjetin e kanalizimit.

Pergjigja e Kryetarit:

Në Qabiq, pothuajse në të gjithë fshatin kemi bërë shtrirjen e rrjetit të kanalizimit,sa i përket shtëpive të reja që keni ndërtuar, do ta shënojmë këtë kërkesë në procesverbal dhe, gjatë viteve të ardhshme, do ta shqyrtojmë mundësinë më të afërt për ta përfshirë në projekt dhe për ta realizuar

Pas përfundimit të diskutimeve, Kryetari deklaroi:

"Nëse nuk ka më kërkesa apo pyetje, e shpall të mbyllur këtë takim.

Komentet, pyetjet, sugjerimet dhe kërkesat e regjistruara sot në procesverbal do të trajtohen në raportin final të dëgjimeve buxhetore. Më pas, ky raport do të shqyrtohet në seancën e rregullt të Kuvendit Komunal.

Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Klinës, ku secili pjesëmarrës do të mund të shohë përgjigjet dhe statusin e kërkesave të paraqitura.

Mirëmbetshi!"

Takimi u mbyll në ora 18:00

Shtojcë – Tabela e pjesëmarrësve të ndarë sipas gjinisë.

Gra	0
Burra	9
Totali	9

Procesmbajtësi,
Egzon Sejdiu

